



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

S T A T U T I I K O M U N Ë S - J U N I K

Junik 2010

Në mbështetje të dispozitave të nenit 12, pika 12.2, shkronja a dhe pika 12. 3 të Ligjit nr. 03/L – 040 për vetëqeverisjen lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/2008), neni 62 të Statutit të Komunës së Junikut i datës: 27.11.2008, Kuvendi i Komunës në Junik, në mbledhjen e mbajtur më 29.09.2010, miratohet:

S T A T U T I I K O M U N Ě S - J U N I K

KAPITULLI I

Dispozitat e përgjithshme

Qëllimi

Neni 1

1.1 Statuti i Komunës është akti më i lartë juridik i Komunës, që miratohet nga Kuvendi i Komunës në pajtim me legjislacionin në fuqi.

1.2 Statuti është bazë për sigurimin e zbatimit të kompetencave dhe përgjegjësi të Komunës, ashtu siç është përcaktuar me Ligjin për vetëqeverisje lokale dhe ligjet tjera.

1.3 Statuti rregullon kompetencat dhe pushtetin e Komunës, pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të qytetarëve në mbledhje, aktivitetet dhe mënyrën e vendosjes në punët publike, organet e Komunës dhe Shërbimin civil, të drejtat dhe detyrat e anëtarëve të Kuvendit, administrimin financiar dhe konfliktin e interesave.

Përkufizimet

Neni 2

Çdo herë kur në këtë Statut përdoren, termat vijuese kanë kuptimin e përcaktuar më poshtë, përveç rasteve kur konteksti ku paraqitet termi i tillë tregon qartë se ka kuptim tjetër:

-**“Komunitet”** -do të thotë grup komuniteti që i përkasin një grupi të njëjtë etnik, fetar apo gjuhësor.

-**“Qeveria”**- do të thotë Qeveria e Republikës së Kosovës.;

-**“Qytetar”** -ka kuptimin e paraqitur në [nenin 10 të Ligjit aktual mbi Shtetësinë];

-**“Vetëqeverisje lokale”**- do të thotë e drejta dhe aftësia e autoriteteve lokale, të themeluara sipas këtij Ligji dhe në kuadër të kufizimeve të tij, që të rregullojnë dhe të menaxhojnë një pjesë substanciale të çështjeve publike nën përgjegjësinë e tyre dhe në interes të popullatës vendore.

-**“Komunë”**- do të thotë njësia themelore e vetëqeverisjes lokale në Kosovë, e përbërë nga qytetarët e komuniteteve në një territor të caktuar të përcaktuar me ligj, siç parashihet në Ligjin mbi numrin, emrat dhe kufijtë administrativë të komunave, nr. 03/L-041;

-**“Kuvendi i Komunës”**- është organi më i lartë i komunës që përbëhet prej anëtarëve të tij të zgjedhur.

-**“Kryetari”**- është organi më i lartë ekzekutiv i komunës që zgjidhet përmes zgjedhjeve të drejtpërdrejta.

-**“Parimi i subsidiaritetit”**- do të thotë që çështjet publike realizohen, sa më shumë që të jetë e mundur, në interes të qytetarëve nga niveli më i ulët i qeverisë që është në gjendje të ofrojë shërbime efikase;

- **“Kompetencat vetanake”**- do të thotë kompetencat që u jepen komunave me kushtetutë apo me ligj për të cilat ato janë plotësisht përgjegjëse për sa i përket interesit lokal, apo në përputhje me ligjin

-**“Kompetencat e deleguara”**- do të thotë kompetencat e qeverisë qendrore dhe të institucioneve të tjera qendrore ekzekutimi i të cilave përkohësisht i caktohet me ligj komunave;

-**“Kompetencat e zgjeruara”**- do të thotë kompetencat që u jepen me ligj një komune, apo një numri komunash;

-**“Rishikimi administrativ”**- është e drejta dhe kompetenca e institucioneve të qeverisë qendrore për ta rishikuar ligjshmërinë e autoriteteve lokale në fushën e kompetencave të zgjeruara dhe ligjshmërinë dhe përshtatshmërinë e aktiviteteve të tyre në fushën e kompetencave të deleguara.

-**“Organi mbikëqyrës”**- do të thotë ministria përgjegjëse për qeverisjen lokale dhe/ose institucionet e tjera të Qeverisë së Republikës së Kosovës. në fushat e tyre përkatëse të përgjegjësisë;

-**“Mbikëqyrja e ligjshmërisë”**- do të thotë rishikimi i realizuar nga organi mbikëqyrës për t’u siguruar se aktet komunale janë nxjerrë në pajtim me dispozitat e zbatueshme ligjore dhe se organi që i ka nxjerrë nuk ka vepruar në tejkalim të mandatit të tij të miratuar ligjor;

-**“Mbikëqyrja e përshtatshmërisë”**- do të thotë rishikimi i bërë nga organi mbikëqyrës për t’u siguruar se kompetencat e deleguara janë ekzekutuar në përputhje me rregullat, kriteret dhe standardet e përcaktuar nga qeveria qendrore dhe për t’u siguruar se masat e marra nga komuna kanë qenë përkatëse për arritjen e objektivave dhe rezultateve të përcaktuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës;

- **“Votim i shumicës”**- do të thotë votim për të cilin kërkohet miratimi i më shumë se gjysmës së anëtarëve të pranishëm dhe votim në mbledhjen në të cilën shqyrtohet propozimi. Ky është një mekanizëm përmes të cilit duhet të merren vendimet e kuvendit të komunës;

-**“Shumica prej dy të tretave (2/3)”**- do të thotë votimi që kërkon miratimin e 2/3 e të gjithë anëtarëve të kuvendit të komunës.

-**“Ministria”**- është thotë ministria përgjegjëse për qeverisjen lokale, nëse konteksti qartazi nuk nënkuptohet ndryshe;

- **“Statuti i komunës”**- është akti kryesor ligjor që miratohet nga Kuvendi Komunal dhe në pajtim me legjislacionin e qeverisë qendrore që rregullon organizimin e brendshëm të komunës;

-**“Rregullorja e punës”**- është akt që miratohet nga kuvendi i komunës që parashikon rregullat e rendit dhe të mirësjelljes;

-**“Rregullore komunale”**- është akt që miratohet nga numri i kërkuar i anëtarëve të kuvendit të Komunës që rregullon një lëmi të caktuar të kompetencave të tij;

Neni 3

Komuna është njësi themelore territoriale e vetëqeverisjes lokale, në të cilën qytetarët e saj realizojnë vetëqeverisjen në pajtim me Ligjin për vetëqeverisjen lokale (në tekstin në vazhdim: LVL), ligjet tjera në fuqi dhe Statutin e Komunës.

Neni 4

4.1 Komuna e Junikut (në tekstin e mëtejme “Komuna”), ka emblemën dhe simbolet, të cilat përdoren brenda territorit të saj në pajtim me Ligjin për simbolet shtetërore.

4.2 Simbolet e Komunës miratohen dhe ndryshohen nga Kuvendi i Komunës, në pajtim me Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Kosovës.

Selia

Neni 5

Selia e Komunës është e vendosur në qendër të qytezës së Junikut. Rruga “Lagja Hoxhaj” pa nr.

Festa e Komunës

Neni 6

6.1 Komuna ka ditën e festes së saj publike me 13 Qershor – Dita e Çlirimit të Komunës.

6.2 Me rastin e ditës së Komunës, Kuvendi i Komunës, Kryetari i Komunës dhe qytetarët e saj krahas manifestimit kulturor, përkujtojnë dëshmorët dhe viktimat e luftës të rënë për lirin e Kosovës. Manifestimi duhet të ketë karakter kulturor, sportiv e civilizues, duke shpalosur vlerat kombëtare e qytetëruese të qytetarëve të saj.

Simbolet

Neni 7

7.1 Komuna do ta ketë emblemen (stemën), flamurin dhe vulat, përmbajtja dhe përdorimi i të cilave rregullohet me një akt të veçantë nënligjor të Komunës, në pajtim me dispozitat kushtetuese e ligjore të Republikës së Kosovës.

Asnjë subjekt dhe person tjetër përveç komunës nuk mund ta përdorë emblemen dhe shenjat komunale apo simbolet pa autorizim paraprak të dhënë nga organet kompetente komunale.

7.2. Kuvendi i Komunës me propozim të Kryetarit të Komunës ndan shpërblime, dekorata dhe mirënjohje. Kuvendi i Komunës, me vendim të veçantë përcakton kushtet dhe mënyrën e ndarjes së shpërblimeve, të dekoratave dhe të mirënjohjeve.

7.3 Komuna ka vulën e rrumbullakët dhe vulën katrore të protokollit “vulat e Komunës”.

a) Vula e rrumbullakët përmban tekstin:

- rrethi i parë: Republika e Kosovës;
- rrethi i dytë: Komuna e Junikut;
- rrethi i tretë:

- a) Zyra e Kryetarit
- b) Kuvendi Komunal
- c) Drejtoria përkatëse

Në mes të vulës është emblema.

b) Vula e protokollit të Komunës ka formën e katrore, me tekstin:

- Republika e Kosovës;
- Komuna e Junikut;
- ____. nr. _____, më _____;
- .
- Nr. i shtojcave.

7.4 Vula e Komunës miratohet apo ndryshohet nga 2/3 e anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

7.5 Vulat e Komunës, të përshkruara në pikat a dhe b, tekstin e kanë në gjuhët në përdorim zyrtar.

7.6 Numrin, dimensionet, mënyrën e mbajtjes dhe të përdorimit të vulave të Komunës, e përcakton Kryetari i Komunës me vendim të veçantë.

Gjuhët

Neni 8

Përdorimi i gjuhëve në Komunë rregullohet në pajtim me Ligjin në fuqi për përdorimin e gjuhëve. Kuvendi i Komunës miraton rregullore komunale të detajuara për përdorimin e gjuhëve brenda territorit të Komunës, siç përcaktohet me ligjin për përdorimin e gjuhëve.

Kompetencat e Komunës

Neni 9

Komuna i ushtron kompetencat vetanake dhe të deleguara në pajtim me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale. /Në tekstin e mëtejshëm Ligji/.

Kompetencat vetanake

Neni 10

Komuna ka kompetenca vetanake në pajtim me Ligjin, në fushat që vijojnë:

- a) Zhvillimin lokal ekonomik,
- b) Planifikimin urban dhe rural,
- c) Shfrytëzimin e tokës dhe zhvillimin e bujqësisë,
- d) Zbatimin e rregulloreve të ndërtimit dhe standardeve për kontrollin e ndërtimit,
- e) Mbrojtjen e mjedisit lokal,
- f) Ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale, duke përfshirë: furnizimin me ujë, kanalizimin dhe drenazhin, trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbeturinave, rrugëve lokale, transportit lokal dhe skemave të nxehtësie lokale,
- g) Përgjigjet ndaj rasteve emergjente lokale,

- h) Ofrimin e arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve edukative, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e mësimdhënësve dhe administratorëve të arsimit,
- i) Promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut,
- j) Ofrimin e përkujdesit publik primar shëndetësor,
- k) Ofrimin e shërbimeve familjare dhe shërbimeve të tjera të mirëqenies sociale, siç është përkujdesi për të cenueshmit, strehimin familjar, përkujdesin fëmijëror, përkujdesin për të moshuarit, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e këtyre qendrave përkujdesëse, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e profesionistëve të mirëqenies sociale,
- l) Banimin publik,
- m) Shëndetësinë publike,
- n) Licencimin e shërbimeve publike dhe objekteve, duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me argëtimin, aktivitete kulturore dhe të lira, ushqimin, strehimin, tregjet, shitësit në rrugë, transportimin lokal publik dhe taksitë,
- o) Emërimin e shesheve, rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike,
- p) Ofrimin dhe mirëmbajtjen e parqeve dhe hapësirës publike,
- q) Turizmit,
- r) Aktivitetet kulturore dhe të lira, dhe
- s) Çdo çështje që nuk është përjashtuar shprehimisht nga kompetenca e tyre, apo që nuk i është përcaktuar një autoriteti tjetër.

Kompetencat e deleguara

Neni 11

Komuna ushtron kompetenca të deleguara nga autoritetet qendrore të Republikës së Kosovës, në pajtim me ligjin, në fushat që vijnë:

- a) Shënimet kadastrale,
- b) Regjistrimin civil,
- c) Regjistrimin e votuesve,
- d) Regjistrimin e biznesit dhe licencimin,
- e) Distribuirimin e pagesave të ndihmës sociale (me përjashtim të pensioneve),
- f) Mbrojtja e pyjeve që ndodhen në territorin e komunës në kuadër të autorizimeve të deleguara nga autoriteti qendror, duke përfshirë edhe dhënien e licencave për prerjen e drunjëve në bazë të rregullave të miratuara nga Qeveria.

Organet e Komunës

Neni 12

Organet e Komunës janë:

1. Kuvendi i Komunës - organi më i lartë i Komunës, dhe
2. Kryetari i Komunës - organi më i lartë ekzekutiv i Komunës.

KAPITULLI II

VENDBANIMET E KOMUNËS

Fshatrat dhe vendbanimet

Neni 13

13.1 Territori dhe Kufijtë Administrativ të Komunës së Junikut janë përcaktuar me Ligjin për Kufijtë Administrativ të Komunave.

13.2 Ndryshimi dhe mënyra e ndryshimit të Kufijve Administrativ të Komunës rregullohet në përputhje me Ligjin për Kufijtë Administrativ në pajtim me nenin 9 dhe 10 .

13.3 Komuna e Junikut është e përbërë prej dy fshatrave:

Jasiq dhe Gjocaj

Dhe njëmbëdhjetë lagjeve:

- | | |
|--------------------------|-------------------------|
| 1. Lagja Agim Ramadani | 7. Lagja Gaxherr i ulët |
| 2. Lagja Bajraktar | 8. Lagja Goç |
| 3. Lagja Berishë | 9. Lagja Hoxhaj |
| 4. Lagja Çok | 10. Lagja Miroc – Malok |
| 5. Lagja Gacafer | 11. Lagja Pepsh |
| 6. Lagja Gaxherr i epërm | |

Bashkëpunimi ndërkomunal

Neni 14

Komuna do të bashkëpunojë dhe do të krijojë partneritete me komunat tjera të Republikës së Kosovës, brenda kompetencave të saj, për kryerjen e funksioneve me interes të përbashkët, në pajtim me Ligjin

Marrëveshjet brenda Komunës

Neni 15

15.1 Komuna brenda territorit të vetë bënë marrëveshje me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane, në mënyrë që të sigurojë përmbushjen e nevojave të banorëve të Komunës.

15.2 Fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane të Komunës, në pajtim me legjislacionin në fuqi, vetëm apo në grupe, me pëlqimin e Komunës mund të ushtrojnë aktivitete që janë në përgjegjësinë e saj.

15.3 Marrëveshjet e përcaktuara duhet të përmbajnë mënyrën dhe procedurat për kryerjen e punëve, burimet dhe lartësinë e mjeteve të nevojshme, në pajtim me prioritetet që i ka përcaktuar Komuna në bazë të të hyrave buxhetore për vitin kalendarik.

15.4 Marrëveshjet nga paragrafët paraprahe shqyrtohen dhe miratohen në Kuvendin e Komunës.

Neni 16

Komuna, në kuadrin e të drejtave dhe detyrave të veta dhe politikës së jashtme të caktuar të Republikës së Kosovës, në pajtim me dispozitat e ligjit dhe me pëlqimin parapra të Ministrisë së Punëve të Jashtme, mund të lidhë marrëveshje bashkëpunimi apo të binjakëzohet me organet e pushtetit lokal te vendeve të tjera.

Neni 17

Kuvendi Komunal mund të bashkohet me kuvendet tjera komunale në asociacione për mbrojtjen dhe promovimin e interesave të përbashkëta.

Shtrirja administrative në vendbanimet e Komunës

Neni 18

18.1 Komuna me vendim të Kuvendit, për vendbanimet e caktuara, mund të themelojë zyra për kryerjen e shërbimeve të caktuara nga kompetenca e organeve të administratës Komunale.

18.2 Objekt i marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet komunës e fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane mund të jenë të gjitha çështjet që janë në kompetencë vetanake të komunës, duke përfshirë:

- furnizimin me ujë, rregullimi i kanalizimit, drenazhimit;
- shëndetësinë publike;
- mbrojtjen lokale të ambientit;
- turizmin;
- hapësirave të hapura dhe varrezave;
- aktivitetet kulturore dhe sportive e të tjera.

KAPITULLI III

PASURIA DHE FINANCAT E KOMUNËS

Pasuria e komunës

Neni 19

19.1 Komuna posedon dhe menaxhon pasuritë e saja të luajtshme dhe të paluajtshme.

19.2 Komuna ka të drejtë të shes dhe të jap me qira pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme sipas ligjit me përjashtim të shitjes së tokës e cila rregullohet me ligj të posaçëm.

19.3 Komuna mban dhe udhëheqë regjistrin e pronës së luajtshme dhe të paluajtshme që ka në shfrytëzim dhe posedim.

19.4 Kryetari i komunës emëron komisione (ad hoc) me qëllim të regjistrimit të pasurisë së tundshme dhe të patundshme të komunës më së voni një (1) muaj para përfundimit të vitit fiskal.

19.5 Të drejtën për të emëruar komisionin për regjistrimin e pasurisë, kryetari mund ta delegoj tek Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe e Financa.

Financat komunale

Neni 20

20.1 Komuna ka Buxhetin dhe të hyrat financiare, për financimin e aktiviteteve të saj. Buxheti dhe financat komunale rregullohen me Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal dhe aktet tjera.

20.2 Buxheti komunal përbëhet prej të hyrave vetanake, grandeve nga Qeveria e Republikës së Kosovës, donacioneve dhe të hyrave të tjera.

20.3 Të gjitha çështjet që janë të lidhura me administrimin financiar të komunës janë përgjegjësi e Kryetarit të Komunës, të cilat përgjegjësi edhe mund të barten tek Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa. Përjashtim nga këto çështje bëjnë ato që janë të rezervuara për Kuvendin Komunal dhe Kryetarin e komunës.

20.4 Kryetari i Komunës raporton para Komitetit për Politikë e Financa dhe Kuvendit të Komunës për situatën ekonomike financiare të komunës dhe për zbatimin e planeve

investuese të komunës, së paku njëherë në gjashtë muaj apo kurdoherë që kërkohet nga kuvendi i komunës apo komiteti.

20.5 Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa – **Zyrtari kryesor financiar** duhet të informoi rregullisht kryetarin e komunës për çështje lidhur me menaxhimin financiar. Ai/ajo duhet ti raportoi Komitetit për Politikë e Financa për menaxhimin financiar duke ia referuar atij të gjitha raportet dhe korrespondencën e dërguar ose pranuar nga MEF. Ai/ajo duhet të ofroi një listë të hollësishme tremujore me të gjitha zotimet e regjistruara, pagesat e bëra individuale, dhe një krahasim të shpenzimeve aktuale tremujore me shpenzimet e buxhetit.

20.6 Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa duhet të jep këshilla financiare Kryetarit të Komunës dhe Komiteteve të Kuvendit, përfshirë këtu edhe vlerësimin financiar të rregulloreve, vendimeve dhe politikave që shqyrtohen nga këto organe të Komunës.

20.7 Konsultimet e buxhetit, gjithashtu përfshijnë edhe informimin e qytetarëve për potencialin e të hyrave komunale, duke përfshirë edhe tatimin në pronë dhe masën në të cilën këto të hyra do të mblidhen.

KAPITULLI IV

FUNKSIONIMI DHE PËRGJEGJËSITË E KUVENDIT TË KOMUNËS DHE KOMITETEVE

Funksionimi dhe përgjegjësitë

Neni 21

21.1 Kuvendi i Komunës është organi më i lartë përfaqësues i Komunës i cili zgjidhet në mënyrë të drejtpërdrejt nga qytetarët, në pajtim me Ligjin mbi zgjedhjet lokale.

- a) Kuvendi i Komunës së Junikut përbëhet nga 15 delegat.
- b) Kuvendi i Komunës funksionon në bazë të Ligjit, të këtij Statuti dhe akteve tjera nënligjore.
- c) Kuvendi i Komunës nuk i delegon përgjegjësitë lidhur me marrjen e vendimeve të cekura në nenin 40 par. 40.2 të Ligjit, për fushat në vijim:
- d) Statutin dhe Rregulloren e punës, rregulloret komunale dhe miratimin, ndryshimin dhe shfuqizimin e tyre,
- e) Miratimin e buxhetit dhe planeve investuese,
- f) Miratimin e çështjeve të tjera financiare, të cilat janë të rezervuara për kuvendin sipas statutit apo rregullores së punës,
- g) Planin vjetor të punës dhe raportin vjetor,
- h) Themelimin e komisioneve të kërkuara sipas Ligjit,
- i) Zgjedhjen e kryesuesit dhe Zëvendëskryesuesin e Kuvendit,
- j) Nivelin e taksave, tarifave dhe gjobave komunale,
- k) Krijimin dhe përdorimin e simboleve, dekoratave dhe titujve të nderit të komunës, në pajtim me ligjin në fuqi,
- l) Emërimin dhe riemërimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike,
- m) Arritjen e marrëveshjeve ndërkomunale dhe brenda komunale,
- n) Marrjen e vendimeve për t'u bashkuar me asociacione përfaqësuese të komunave të Republikës së Kosovës dhe
- o) Përgjegjësi të tjera që kërkohen me ligj.

21.2 Për marrjen e vendimeve, Kuvendi i Komunës mund t'ia delegojë pushtetin e tij komiteteve, apo Kryetarit të Komunës. Kuvendi i Komunës mund të tërheqë delegimin në çdo kohë.

Aktet e Kuvendit të Komunës

Neni 22

22.1 Kuvendi i Komunës miraton akte brenda kompetencave të tij në pajtim me dispozitat e nenit 12 të Ligjit. Këto akte përfshijnë:

1. Statutin e Komunës,
2. Rregulloren e punës së Kuvendit,
3. Rregulloret komunale, dhe
4. Çdo akt tjetër të nevojshëm apo të duhur për funksionim efikas të komunës.

22.2 Aktet e Kuvendit të Komunës vlejnë për territorin e Komunës së Junikut.

Anëtarët e Kuvendit

Neni 23

23.1 Mandati i anëtarëve të Kuvendit të Komunës është katër vite.

23.2 Obligimet dhe të drejtat e anëtarëve të kuvendit realizohen në pajtim me dispozitat e nenit 39 të Ligjit dhe sipas rregullores për punën e Kuvendit.

23.3 Anëtari i Kuvendit të Komunës pushon të jetë anëtar i Kuvendit sipas kushteve të parapara me nenin 37 par. 37.2 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale.

Informimi i anëtarëve të kuvendit për çështjet komunale

Neni 24

24.1 Kërkesat për informata që kanë të bëjnë me çështjet komunale, të cilat bëhen nga anëtarët e Kuvendit të Komunës, duhet të adresohen me shkrim tek organi kompetent i Komunës.

24.2 Organi kompetent i Komunës në afat prej 15 ditëve duhet t'i përgjigjet me shkrim anëtarit ose anëtarëve të kuvendit të komunës.

24.3 Në rast se organi kompetent nuk e jep përgjigjen në afatin e paraparë sipas paragrafit paraprak, anëtari i Kuvendit mund të ngritë çështjen për sqarim në Kuvendin e komunës.

Konflikti i interesave

Neni 25

25.1 Anëtarët e Kuvendit të Komunës, janë të obliguar të paraqesin konfliktet e interesit në pajtim me dispozitat e nenit 38 të LVL-së.

25.2 Nëse Kuvendi ose komiteti gjatë shqyrtimit të çështjeve të caktuara, konstaton ekzistimin e konfliktit të interesit të ndonjë anëtari, vendos me shumicë votash të anëtarëve prezent për përjashtimin e tij nga procesi i vendimmarrjes.

Mbledhja e parë dhe betimi i anëtarëve

Neni 26

26.1 Kuvendi i Komunës mbanë mbledhjen e parë inauguruese brenda 15 ditëve nga data e vërtetimit të rezultateve zgjedhore, sipas procedurës së paraparë me dispozitat e nenin 42 të Ligjit.

26.2 Anëtarët e Kuvendit të Komunës duhet ta nënshkruajnë deklaratën e betimit solemn.

26.3 Përmbajtja e tekstit për betimin solemn është si vijon: “Unë _____ betohem se do ti kryej me nderë, me besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do ti ushtroj autorizimet e mija si delegat i Kuvendit të Komunës Junik, në mënyrë që të sigurohen kushtet për një jetë të qetë për të gjithë”.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Neni 27

27.1 Kuvendi i Komunës e zgjedh Kryesuesin e Kuvendit të Komunës nga _____ radhët e anëtarëve të vet, me shumicën e votave të anëtarëve të zgjedhur, sipas procedurës së përcaktuar me nenin 41 të Ligjit për VL.

27.2 Kryesuesi i Kuvendit të Komunës i thërret dhe kryeson mbledhjet e Kuvendit të Komunës.

27.3 Në mungesë të Kryesuesit të Kuvendit, Rregullorja e Punës, rregullon se kush konvokon dhe kryeson mbledhjet e Kuvendit të Komunës.

Zevendëskryesuesi i Kuvendit të Komitetit për Komunitete

Neni 28

28.1 Kuvendi i Komunës cakton Zëvendëskryesuesin e Kuvendit të Komunës për Komunitete në pajtim me nenin 54 të Ligjit.

28.2 Zëvendëskryesuesi për komunitete kryen detyrat në pajtim me dispozitat e nenit 55 të Ligjit.

Rregullorja e punës

Neni 29

29.1 Kuvendi i Komunës miraton Rregulloren e punës.

29.2 Me Rregulloren e punës saktësohen procedurat për thirrjen, udhëheqjen, ecurinë e mbajtjes së mbledhjeve, procesverbalin dhe procedurat e votimit.

29.3 Rregullorja e punës ose ndryshimet e saj konsiderohen të miratuara kur për këtë votojnë më shumë se gjysma e anëtarëve të pranishëm në mbledhje.

Thirrja e mbledhjeve dhe përcaktimi i rendit të ditës

Neni 30

30.1 Kryesuesi i Kuvendit të Komunës thërret dhe kryeson mbledhjet e Kuvendit.

30.2 Rendi i ditës për mbledhjen e Kuvendit caktohet nga Kryesuesi i Kuvendit në marrëveshje me Kryetarin e Komunës.

30.3 Anëtari i kuvendit të komunës mund të kërkojë shtimin e një pike në rendin e ditës gjatë seancës së rregullt të Kuvendit të Komunës, nëse çështja që kërkohet të përfshihet në rend të ditës është çështje urgjente me rëndësi publike.

30.4 Kuvendi i Komunës thërret mbledhjet sipas Rregullores për punën e Kuvendit dhe mbanë së paku dhjetë (10) mbledhje të rregullta brenda vitit, pesë (5) prej të cilave në gjashtëmujorin e parë të vitit.

30.5 Përveç mbledhjeve të rregullta, Kuvendi i Komunës mund të mbajë mbledhje të jashtëzakonshme në pajtim me dispozitat e nenit 44 të LVL.

30.6 Anëtarët e Kuvendit të Komunës, për kohën, datën dhe vendin e mbajtjes së mbledhjes si dhe për rendin e ditës, duhet të njoftohen së paku shtatë ditë pune, para mbledhjes të Kuvendit të Komunës, ose tri ditë pune më herët në raste urgjente. Njoftimet publike për këto çështje shpallen në të njëjtën kohë.

Kuorumi dhe mënyra e votimit

Neni 31

31.1 Kuorumi për mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe komiteteve të tij përbëhet nga gjysma e anëtarëve të pranishëm në mbledhje me të drejtë votimi.

31.2 Në mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe të Komiteteve, për çështjet që votohen, çdo anëtarë ka të drejtën e vetëm një vote. Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, ka votën vendimtare, në rast të numrit të njëjtë të votave për ose kundër ndonjë propozimi.

31.3 Kuvendi i Komunës dhe Komitetet marrin vendime me votim të hapur, ndërsa, me votim të fshehtë në rastet e parapara me ligj.

31.4 Vendimet e Kuvendit të Komunës dhe Komiteteve, nëse me ligj dhe me këtë Statut nuk parashihet ndryshe, merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm dhe të cilët votojnë.

Procesverbali

Neni 32.

32.1 Për të gjitha mbledhjet e Kuvendit dhe të Komiteteve të tij mbahet procesverbali. Procesverbali përfshin emrat e anëtarëve të pranishëm dhe anëtarëve të ftuar, rendin e ditës, thelbin e diskutimit, rezultatin numerik të votimit dhe propozimet e miratuara apo të refuzuara. Nëse kërkohet të thirret me emër secili anëtar, në procesverbal shënohet si ka votuar secili prej tyre.

32.2 Procesverbalin e mban një shërbyes civil komunal, i caktuar nga shefi i personelit. Procesverbali duhet të miratohet në mbledhjen e ardhshme. Çdokush ka të drejtë ta shikojë procesverbalin dhe ta marrë një kopje.

32.3 Kryesuesi e nënshkruan procesverbalin e miratuar.

Shpërndarja e kuvendit jofunksionues të komunës

Neni33

33.1 Nëse kuvendi i komunës dështon në kryerjen e funksionit të detyrueshëm sipas standardeve të përcaktuara me ligj, apo nëse bëhet jofunksionuese dhe kështu rrezikon ushtrimin e të drejtave themelore të qytetarëve, ministria përgjegjëse për qeverisje lokale njofton komunën për dështimin dhe kërkon që të ndërmerren masa të duhura në mënyrë që të sigurohet kryerje e qetë e funksionit komunal.

33.2 Kuvendi i Komunës konsiderohet jo funksionuse nëse:

- a) nuk e zgjedh kryesuesin, tridhjetë (30) ditë pas themelimit;
- b) nuk miraton statutin e saj brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh pas themelimit
- c) nuk miraton buxhetin sipas afatit të paraparë me ligjin përkatës; ose
- d) nuk mban mbledhje për një periudhë më të gjatë se gjashtë (6) muaj;

Ministria përgjegjëse për qeverisje lokale e njofton Qeverinë e Republikës së Kosovës për mosfunksionimin e komunës. Qeveria mund ta shpërndajë kuvendin e komunës jofunksionues.

Kompensimi

Neni 34

Kuvendi i Komunës, në pajtim me ligjin ose me aktet e tjera nënligjore, nxjerr vendim për mënyrën dhe lartësinë e kompensimit të punës për anëtarët e Kuvendit, Kryesuesin, Zëvendëskryesuesin e Kuvendit, si dhe për kryesuesit dhe anëtarët e komiteteve.

Komitetet e Kuvendit të Komunës

Neni 35

35.1 Kuvendi i Komunës themelon Komitete të përhershme dhe komitete tjera për të cilat konsideron se janë të domosdoshme për kryerjen e përgjegjësive të Komunës.

35.2 Nëse nuk parashihet ndryshe me ligj, Komitetet reflektojnë përbërjen e Kuvendit të Komunës.

Komitetet

Neni 36

Kuvendi i Komunës themelon Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Komitetin për Komunitete, si komitete të përhershme.

Komiteti për Politikë dhe Financa

Neni 37

37.1 Komitetit për Politikë dhe Financa formohet prej anëtarëve nga përbërja e Kuvendit të Komunës, numri dhe struktura e të cilëve caktohet me vendim të Kuvendit.

37.2 Komiteti për Politikë dhe Financa kryesohet nga kryesuesi i Kuvendit të Komunës dhe përbërja e tij duhet të reflektojë përfaqësimin e entiteteve politike.

37.3 Komiteti për Politikë dhe Financa është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave, duke përfshirë dokumentet e planifikimit strategjik, kornizën vjetore buxhetore afatmesme, planin vjetor të prokurimit, rregulloren vjetore për tatimet, tarifat dhe pagesat, planin vjetor të punës për auditimin e brendshëm, buxhetin vjetor afatmesëm dhe çdo ndryshim të buxhetit gjatë vitit fiskal si dhe për marrjen e raporteve nga kryetari dhe dorëzimin e rekomandimeve në kuvendin e komunës.

Komiteti për Komunitete

Neni 38

38.1 Komiteti për Komunitete përfshinë në radhët e veta shumicën e thjeshtë nga anëtarët e Kuvendit të Komunës, anëtarët tjerë janë përfaqësuesit e komuniteteve.

38.2 Çdo komunitet që jeton në komunë përfaqësohet nga, së paku një përfaqësues në komitetin për komunitete. Përfaqësuesit e komuniteteve joshumicë në komunë e përbëjnë shumicën e anëtarëve të komitetit të komuniteteve.

38.3 Komiteti i Komuniteteve është përgjegjës për shqyrtimin e përputhshmërisë së autoriteteve komunale me ligjin në zbatim dhe për shqyrtimin e të gjitha politikave komunale, praktikave dhe aktiviteteve për t'u siguruar se të drejtat dhe interesat e komuniteteve respektohen plotësisht. Komiteti gjithashtu i rekomandon Kuvendit të Komunës masat që duhet të ndermirren për të siguruar jetësimin e dispozitave që kanë të bëjnë me nevojën e komuniteteve për t'u avancuar, shprehur, mbrojtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor, si dhe për të siguruar mbrojtje adekuate të të drejtave të komuniteteve brenda komunës.

Komitetet tjera

Neni 39

39.1 Kuvendi i Komunës, përveç Komiteteve të përhershme, me vendim, mund të themelon komitete të tjera për të cilat konsideron se janë të nevojshme për kryerjen e përgjegjësi të tyre si; Komiteti për arsim dhe kulturë, komiteti për shëndetësi dhe mirëqenie sociale dhe komiteti për zhvillim ekonomik etj sipas nevoje.

39.2 Kuvendi për shqyrtimin e çështjeve të caktuara mund të ngrit edhe komisione ad hoc.

KAPITULLI V

UDHEHEQESIA KOMUNALE/ EKZEKUTIVI

Zgjedhja e kryetarit të komunës

Neni 40

40.1 Kryetari i komunës zgjidhet me zgjedhje të drejtpërdrejta në pajtim me ligjin mbi zgjedhjet lokale.

40.2 Kryetari i komunës zgjidhet për një periudhë katër vjeçare. .

40.3 Mandati i kryetarit të komunës përfundon;

a) kur ta kryejë mandatin e tij;

b) nëse vdes;

c) nëse jep dorëheqje;

d) nëse ndërron vendbanimin në komunë tjetër;

e) nëse nuk paraqitet në punë për më shumë se 1 muaj pa arsye;

f) nëse shkarkohet nga detyra në pajtim me këtë ligj;

g) në rast të vendimit përfundimtar të gjyqit që e privon kryetarin e komunës nga cilësia juridike;

dhe

g) në rast të dënimit për veprë penale me një urdhër për burgim për gjashtë (6) muaj ose më tepër.

Betimi

Neni 41

41.1 Kryetari i Komunës, pas zgjedhjes e jep betimin solemn para anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

41.2 Përmbajtja e tekstit për betimin solemn është si vijon: “Betohe se do t’i kryej detyrat dhe do t’i ushtroj kompetencat e mia si Kryetar i Komunës së Junikut me nderë, besnikëri, paanshmëri, me ndërgjegje dhe në pajtim me ligjin, në mënyrë që të sigurohen kushtet për një jetë të qetë për të gjithë.”

Përgjegjësitë

Neni 42

Kryetari i komunës i zbaton përgjegjësitë në vijim:

- a. Përfaqëson komunën dhe vepron në emër të saj,
- b. Udhëheq ekzekutivin e komunës dhe administratën e saj dhe mbikëqyrë administrimin financiar të komunës,
- c. Ushtron të gjitha kompetencat, të cilat nuk i jepen në mënyrë eksplicite Kuvendit të Komunës apo komiteteve të tij,
- d. Deleton përgjegjësit të drejtorët e Drejtorive dhe mbikëqyrë zbatimin e
- e. përgjegjësisë të deleguara,
- f. Ekzekuton aktet e Kuvendit të Komunës,
- g. Emëron apo shkarkon zëvendësit e tij/saj,
- h. Emëron dhe shkarkon anëtarët e tij të cilët i ndihmojnë atij në kryerjen e detyrave;
- i. Organizon punën dhe drejton politikën e komunës,
- j. Propozon rregullore apo akte të tjera për miratim në Kuvendin e Komunës,
- k. Propozon zhvillimin komunal, planet rregullative dhe investuese, propozon buxhetin vjetor për miratim në Kuvendin e Komunës dhe e ekzekuton buxhetin e miratuar,
- l. Raporton para Kuvendit të Komunës për situatën ekonomiko-financiare të komunës dhe për zbatimin e planeve investuese të komunës, së paku njëherë në gjashtë muaj apo kurdoherë që kërkohet nga Kuvendi i Komunës,
- m. Mund të kërkojë që Kuvendi i Komunës ta shqyrtojë një akt komunal para hyrjes në fuqi, kur konsideron se akti cenon legjislacionin në zbatim dhe/apo interesin e komuniteteve,
- n. Do të konsultojë nënkryetarin për komunitete për çështjet që kanë të bëjnë me komunitetin jo shumicë dhe
- o. Aktivitete tjera të përcaktuara me dispozita ligjore
- p. Të beje ndryshimin lidhur me funksionimin dhe numrin e drejtorive dhe funksionet e tyre lidhur me legjislacionin në fuqi.

Aktet e Kryetarit të Komunës

Neni 43

Përpos Përgjegjësisë të përcaktuara me nenin 41 të këtij statuti, kryetari i komunës nxjerrë urdhëresa administrative dhe vendime brenda fushëveprimit të kompetencave të tija.

Konflikti i interesit

Neni 44

44.1 Kryetari, nënkryetari, dhe anëtarët e Këshillit të Drejtorëve, përjashtohen nga procedurat lidhur me marrjen e vendimeve që kanë të bëjnë me cilëndo çështje, në të cilën ai ose ajo, apo ndonjë anëtar i afërt i familjes ka interes personal apo financiar.

44.2 Kur ndonjëri nga anëtarët e Këshillit të Drejtorëve ka konflikt interesi, Kryetari cakton rolin e tij që ka të bëjë me çështjen e caktuar, që ky rol të ushtrohet nga vet ai (ajo), ose nga drejtori që vepron në mbikëqyrjen e tij (saj) e që nuk ka konflikt interesi.

44.3 Kryetari i Komunës është i obliguar të paraqes konfliktet e interesit në pajtim me dispozitat e nenit 59 të Ligjit për VL.

Nënkryetari i Komunës

Neni 45

45.1 Nënkryetari emërohet nga Kryetari për të njëjtin mandat dhe shkarkohet nga Kryetari.

45.2 Me kërkesë të Kryetarit, Nënkryetari i ndihmon Kryetarit në ushtrimin e funksioneve ekzekutive të përditshme dhe vepron në emër të Kryetarit në mungesë të tij.

45.3 Kur posti i Nënkryetarit mbetet i lirë, Kryetari emëron Nënkryetarin e ri, jo më vonë se tridhjetë ditë pas paraqitjes së postit të lirë.

Në raste të konfliktet të interesit të Nënkryetarit zbatohen dispozitat e njëjta nga neni 59 të ligjit për VL.

Nënkryetari i Komunës për komunitete

Neni 46

Komuna në pajtim me nenin 61 par. 61.1 të LVL, do të ketë Nënkryetarin për komunitete jo shumicë.

KAPITULLI VI

ADMINISTRATA KOMUNALE

Organizimi i brendshëm

Neni 47

47.1 Administrata Komunale përbëhet nga Zyra e Kryetarit të Komunës, dhe Drejtoritë Komunale.

47.2 Zyra e Kryetarit të Komunës dhe Drejtoritë Komunale ushtrojnë kompetencat nga fushëveprimi i Komunës të përcaktuara me dispozita ligjore dhe me këtë statut.

47.3 Në kuadër të Zyrës së Kryetarit të Komunës dhe të Drejtorive, mund të themelohen Sektorët.

47.4 Zyrën e Kryetarit të komunës e udhëheqë Kryetari në mënyrë të drejtpërdrejt, Drejtoritë i udhëheqin drejtorët e emëruar nga Kryetari i Komunës, Sektorët i udhëheqin shefat e sektorëve.

47.5 Drejtorët udhëheqin Drejtorin e tyre në përputhje me udhëzimet strategjike dhe politike të Kryetarit në pajtim me Ligjin dhe Rregulloret Komunale në fuqi.

47.6 Drejtorët e drejtorive i raportojnë rregullisht Kryetarit për çështje që janë nën përgjegjësinë e tyre dhe i ofrojnë të gjitha informatat dhe raportet e nevojshme për procesin e vendimmarrjes.

Zyra e Kryetarit të komunës

Neni 48

48.1 Në zyrën e Kryetarit të Komunës organizohen zyrtarët konkret që hyjnë në funksion të mbarëvajtjes së aktiviteteve të Kryetarit:

1. Auditori i brendshëm
2. Zyra e prokurimit
3. Zyra për integritet evropian dhe te drejta te njeriut
4. Udhëheqësi i personelit
5. Zyra për diasporë

Drejtoria komunale

Neni 49

Komuna me këtë Statut themelon drejtorit komunale, me emërtime si vijon:

1. Drejtoria për Administratë të përgjithshme,
2. Drejtoria për Buxhet dhe Financa,
3. Drejtoria për Ekonomi, dhe zhvillim,
4. Drejtoria për Urbanizëm Kadastër dhe Mjedis
5. Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport,
6. Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale,
7. Drejtoria për Shërbime Publike Inspeksion Mbrojtje dhe Shpëtim

Drejtoria për Administratë

Neni 50

50.1 Në kuadër të Drejtorisë për Administratë themelohen sektorët me emërtimet në vijim:

1. Sektori për Administratë të Përgjithshme,
2. Sektori për Gjendjen Civile
3. Sektori pritës, protokoll dhe arkiva

Drejtoria për Buxhet dhe Financa

Neni 51

51.1. Në kuadër të kësaj Drejtorie themelohen sektorët me emërtimet në vijim:

1. Sektori për buxhet
- 2, Sektori për financa,
3. Sektori për tatim në pronë,

Drejtoria e Ekonomisë dhe Zhvillimit

Neni 52

52.1 Në kuadër të kësaj Drejtorie themelohen sektorët me emërtimet në vijim:

1. Sektori për zhvillim strategjik dhe turizëm,
2. Sektori për bujqësi dhe pylltari,

Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mjedis

Neni 53

53.1 Në kuadër të kësaj drejtorie themelohen sektorët me emërtimet në vijim:

1. Sektori për Urbanizëm
2. Sektori për Kadastër,
3. Sektori për Mjedis.

Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport.

Neni 54

54.1 Në kuadër të kësaj drejtorie themelohen sektorët me emërtimet në vijim:

1. Sektori për Arsim,
2. Sektori për Kulturë, Rini e Sport,

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Neni 55

55.1 Në kuadër të kësaj Drejtorie themelohen sektorët me emërtimet në vijim:

1. Sektori për Shëndetësi
2. Sektori për Mirëqenie Sociale

Drejtoria për Shërbime Publike Inspeksion Mbrojtje dhe Shpëtim

Neni 56

56.1 Në kuadër të kësaj drejtorie themelohen sektorët me emërtimet në vijim:

1. Sektori për Shërbime Publike,
2. Sektori për Mbrojtje dhe Shpëtim,
3. Sektori për Inspeksion.

Këshilli i Drejtoreve

Neni 57

57.1 Këshilli i Drejtorëve përbëhet nga drejtorët e emëruar nga Kryetari i Komunës.

57.2 Secili anëtar i Këshillit të Drejtorëve:

- a) I raporton rregullisht Kryetarit për çështjet që janë në përgjegjësinë e tij;
- b) Ndihmon Kryetarin, Kryesuesin e Kuvendit të Komunës dhe komitetet e tij, duke iu ofruar të gjitha informatat dhe raportet e nevojshme për procesin e vendimmarrjes;
- c) Zbaton të gjitha rregulloret dhe vendimet e Kuvendit të Komunës dhe ligjet e miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës;
- d) Përgatit programin e punës dhe prezanton raportet periodike të punës për drejtorinë e tij;
- e) Është përgjegjës për udhëheqjen dhe kontrollimin e përditshëm të punës së drejtorive;
- f) Përgatit dhe prezanton planet periodike të zhvillimit në sferën e tyre të përgjegjësisë dhe përcjelljen e këtyre planeve;
- g) Përgjigjet në mënyrë efektive për çfarëdo ankese lidhur me sferën e vet të përgjegjësisë;
- h) Merr pjesë dhe kontribuon në punën e Kuvendit të Komunës, të komiteteve përkatëse;
- i) Siguron se do të ofrojë një qasje të drejtë dhe të barabartë për ato shërbime publike që janë në përgjegjësinë e tij;
- j) Përmbush të gjitha detyrat dhe urdhëresat që i caktohen në mënyrë adekuate.

KAPITULLI VII

SHËRBIMI CIVIL KOMUNAL

Shërbyesi civil

Neni 58

58.1 Shërbimi civil komunal përfshin të gjithë personat e punësuar nga autoriteti komunal, rroga e të cilëve paguhet nga buxheti i Republikës së Kosovës, përveç: Kryetarit, Nënkyetarit dhe Drejtorëve komunal, Kryesuesit, Zëvendëkryesuesit dhe të gjithë anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

58.2 Drejtorët komunal, drejtorët e institucioneve dhe ndërmarrjeve nën autoritetin e komunës dhe nëpunësit civil të administratës së Komunës nuk mund të jenë anëtar të Kuvendit të republikës së Kosovës apo anëtar të kuvendit të komunës ku ata punojnë.

58.3 Zgjedhjet për kuvendin e komunës nuk përbejnë shkak për rishqyrtimin e pozitive të shërbyesve civil.

Udhëheqja

Neni 59

Shërbimi civil komunal udhëhiqet në bazë të parimeve dhe procedurave të përcaktuar me legjislacionin në fuqi. Me rastin e rekrutimit të personelit të Komunës duhet respektuar procedurat e hapura dhe konkurruese për të pranuar shërbyes civil të Komunës me kualitet të lartë, në bazë të meritave dhe kompetencave.

Udhëheqësi i personelit

Neni 60

Administrata komunale ka udhëheqësin e personelit, i cili rekrutohet nga Kryetari i Komunës, në pajtim me rregullat dhe procedurat ligjore të Shërbimit civil në Republikën e Kosovës.

Punësimi

Neni 61

61.1 Punësimi në shërbimin civil komunal duhet të mbikëqyret dhe rregullohet nga udhëheqësi i personelit për të siguruar që shërbimi civil reflekton në proporcion të drejtë profesional, gjinor dhe etnik në harmoni me ligjin.

61.2 Shërbimi Civil Komunal si tërësi duhet që të përmbajë proporcion të drejtë të përfaqësimit të personave me aftësi të kufizuara.

61.3 Nëpunësi i administratës komunale përjashtohet nga vendimmarrja dhe procedurat administrative lidhur me ndonjë çështje në të cilën ai apo ajo, ose ndonjë anëtar i afërm i familjes së tij, ka interes personal ose financiar.

Administrimi financiar

Buxheti i Komunës

Neni 62

62.1 Për t'i përmbushur të drejtat dhe detyrimet e saj, Komuna ka buxhetin e saj (buxheti i Komunës).

62.2 Buxheti i Komunës duhet të jetë i balancuar, i përgatitur në mënyrë transparente dhe i bazuar në kritere objektive.

62.3 Buxheti i Komunës duhet të përmbajë planin për aktivitetet dhe udhëheqje ekonomike brenda vitit fiskal, dhe duhet të përfshijë të gjitha parashikimet e të hyrave, shpenzimet kapitale dhe ato të përditshme të Komunës. Ai gjithashtu duhet t'i ndajë fondet ekzistuese për nevojat e shpenzimeve të Komunës.

Të hyrat nga Ministria e Financave dhe e Ekonomisë

Neni 63

63.1 Qeveria, përmes Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë, bën transferime financiare për komunat, duke u bazuar në kriteret objektive, përfshirë edhe vlerësimin e nevojave dhe burimeve financiare për Komunë.

63.2 Një pjesë e këtyre fondeve të transferuara, mund të ndahet për veprimtari të caktuara specifike. Komuna mund të pranojë grante operative nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës (BKK). Grantet operative janë: (i) grantet e përgjithshme, (ii) grantet specifike për Arsim dhe grantet specifike për shëndetësi.

63.3 Komuna duhet të njoftohet për shumën e fondit të transferuar për vitin e ri fiskal, në përputhje me Ligjin për financat e pushtetit lokal.

Të hyrat vetanake të Komunës

Neni 64

Komuna, në pajtim me ligjet dhe aktet nënligjore, krijon të hyra vetanake nga:

- a) tatimi në pronën e paluajtshme;
- b) taksat për lejen e ushtrimit të veprimtarisë afariste;
- c) taksat për lejen për shërbime profesionale;
- d) taksat për automjete motorike;
- e) taksat administrative komunale;
- f) taksat e lejeve për ndërtimin dhe rrënimin e ndërtesave dhe strukturave të tjera;
- g) taksa të tjera komunale;
- h) taksa për lëshimin e certifikatave dhe dokumenteve zyrtare;
- i) tarifatat për zhvillimin ose ruajtjen e infrastrukturës;
- j) gjobat në trafik;
- k) gjobat për shkeljen e rregulloreve komunale;
- l) të hyrat nga qiradhënia;
- m) bashkëpagesat për arsim dhe shëndetësi.

Të hyrat tjera

Të hyrat nga donatorët

Neni 65

65.1 Për ta ndihmuar zhvillimin e Komunës, donatorët mund të derdhin mjetet në buxhetin e Komunës.

65.2 Nëse donatorët derdhin mjete në buxhetin e Komunës me destinim të caktuar, ato mjete nuk mund të përdoren për qëllime të tjera.

65.3 Donatorët kanë të drejtë të informohen për mënyrën e harxhimit të mjeteve që i kanë derdhur në buxhetin e Komunës.

Të hyrat nga vetëkontributi

Neni 66

Për t'i përmbushur më mirë, apo për t'i përmirësuar nevojat e banorëve të saj, Komuna mund të sigurojë mjete edhe përmes deklarimit të drejtpërdrejtë të qytetarëve, në pajtim me ligjet në fuqi. Mjetet e siguruara në këtë mënyrë mund të shfrytëzohen vetëm për atë qëllim që janë deklaruar qytetarët. Mënyra e deklarimit dhe çështjet tjera që kanë

të bëjnë me vetëkontributin, më hollësisht definojnë me ligj dhe me vendim për dhënie e vetëkontributit.

Neni 67

67.1 Komuna ka në dispozicion, në mënyrë të pavarur, të hyrat që i takojnë.

67.2 Për mënyrën e përdorimit të mjeteve, Kuvendi i Komunës duhet të vendosë në pajtim me ligjet në fuqi.

Neni 68

Buxheti i Komunës miratohet për një vit fiskal. Viti fiskal fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor.

Huamarrja komunale

Neni 69

Huamarrja nga komunat rregullohet në bazë të dispozitave të Ligjit për financat e pushtetit lokal dhe Ligjit për borxhe publike.

KAPITULLI VIII

Raporti vjetor

Neni 70

70.1 Kuvendi i Komunës miraton raportin vjetor të Kryetarit të Komunës pas propozimit të Komitetit për Politikë dhe Financa, më së largu deri më 31 mars të vitit vijues.

70.2 Raporti përbëhet nga këto pjesë: titulli, hyrja, metodologjia, rezultatet, konkluzionet, rekomandimet, anekset dhe bibliografia.

Ndërmarrjet publike lokale

Neni 71

71.1 Ndërmarrjet publike lokale janë të përcaktuara me Ligjin për ndërmarrjet publike.

71.2 Komuna të drejtën e saj si aksionare në NPL, do ta ushtrojë përmes Komisionit Komunal të Aksionarëve.

71.3 Komisioni Komunal i Aksionarëve ka të drejtë të veprojë në emër të Komunës, në përputhje me Ligjin për ndërmarrjet publike dhe Ligjin për shoqëritë tregtare.

71.4 Komisioni Komunal i Aksionarëve i raporton Kuvendit të Komunës, për çdo vit, për të arriturat e ndërmarrjeve publike.

KAPITULLI IX

Auditori i brendshëm

Neni 72

Auditori i brendshëm është i autorizuar dhe ka përgjegjësi në pajtim me dispozitat e Ligjit për auditim të brendshëm,

KAPITULLI X

TRANSPARENCA, KONSULTIMET ME PUBLIKUN, DHE MEKANIZMAT E PJESËMARRJES SË QYTETARËVE

Transparenca

Neni 73

73.1 Mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe komiteteve të Kuvendit janë të hapura për publikun dhe përfaqësuesit e mediave.

73.2 Kuvendi i Komunës dhe komitetet e tij, mund të vendosin për mospjesëmarrje të publikut në mbledhje ose një pjesë të sajë, duke përfshirë edhe përfaqësuesit e mediave, në rastet kur natyra e çështjeve që shqyrtohen mund të marrë përmasa të dëmshme për interes të përgjithshëm publik.

73.3 Komuna themelon organin e informimit përmes të cilit e bënë publikimin e rregullativës, aktiviteteve si dhe të arriturve nga lëmi të ndryshme.

73.4 Komuna do të ju ofroj qytetareve qasje në dokumentet zyrtare sipas ligjeve në fuqi.

Takimet publike, konsultimet dhe pjesëmarrja e publikut

Neni 74

74.1 Takimet me publikun duhet të mbahen në një sallë që është e mjaftueshme për pjesëmarrjen e publikut të interesuar. Komuna duhet të mbajë së paku dy takime me publikun çdo vit, një në gjashtëmujorin e parë dhe një tjetër në gjashtëmujorin e dytë.

74.2 Përveç kësaj, takimet tjera me publikun mund të mbahen, duke marrë parasysh se duhet të ekzistoj një interval prej dy muajsh ndërmjet dy takimeve.

74.3 Vendi, data dhe koha e mbajtjes së takimit publik duhet të shpallen së paku dy javë para mbajtjes së takimit. Përfaqësuesit e mediave duhet të lejohen të marrin pjesë në të gjitha takimet me publikun.

74.4 Kryetari i Komunës duhet ta kryesoj mbledhjen me publikun. Ai/ajo duhet ta ketë autoritetin ta përcaktojë procedurën e cila do të shfrytëzohet gjatë mbledhjes si dhe ka autoritetin të mos lejoj diskutimin për disa çështje të caktuara që nuk janë të lidhura me

çështjet e diskutuara apo që nuk janë në kuadër të pushtetit të komunës dhe nuk kanë të bëjnë me punët e komunës.

74.5 Nëse bëhet një pyetje në takim publik, që nuk mund të ketë përgjigje gjatë takimit, pyetësi mund të kërkojë përgjigje me shkrim në një periudhë prej 30 ditësh, pas ditës së takimit.

74.6 Ai/ajo mund të vendosë të mos i dëgjojë folësit të cilët prezantojnë pikëpamje të njëjta apo i përsërisin ato dhe mund të përcaktojnë një limit kohor për kohën të cilën e kanë në dispozicion folësit.

74.7 Komuna me rastin e marrjes së vendimeve dhe miratimit të rregulloreve nga kompetenca e vet, paraprakisht do të konsultoj publikun, në mënyrë që të merren parasysh sugjerimet dhe propozimet e publikut.

74.8 Komuna shfrytëzon format e konsultimit të publikut, si vijon:

- a) Publikimi i projekteve, akteve dhe rregulloreve në organin e informimit të Komunës, në tabelën e shpalljeve dhe në Web-faqen e Komunës,
- b) Organizimi i konsultave me publikun-grupeve të interesuara për të cilat ka të bëjë çështja e caktuar para se të miratohen në Kuvend dhe
- c) Organizimi i tryezave dhe anketave me qytetarë.

Komuna do të ndërmarr edhe masa tjera lidhur me informimin publik dhe konsultimin e publikut të parapara me dispozitat e nenit 68 të ligjit për vetëqeverisjen lokale.

Iniciativa e qytetarëve

Neni 75

75.1 Qytetarët mund të marrin iniciativë për të propozuar rregullore, brenda kompetencave të komunës, për miratim nga kuvendi apo me votën e qytetarëve, në pajtim me ligjin në zbatim.

75.2 Propozuesit ia dorëzojnë draftin e rregullores së propozuar kryesuesit të kuvendit të komunës.

75.3 Draft rregullorja e propozuar duhet të nënshkruhet nga 15% e votuesve të regjistruar për t'u shqyrtuar nga Kuvendi i Komunës.

75.4 Kuvendi i komunës është i obliguar ta shqyrtojë rregulloren e propozuar brenda 60 ditësh pas pranimit.

KAPITULLI XI

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 76

Statuti i Komunës dhe ndryshimet e tij, miratohen në Kuvend, kur për të votojnë dy të tretat (2/3) e anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

Neni 77

Në rastet kur ekziston ndonjë konflikt midis dispozitave të këtij statuti me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, dispozitat e Ligjit mbizotërojnë.

Neni 78

Ky statut hynë në fuqi tetë (8) ditë pas publikimit në web-faqen e Komunës dhe tabelën e shpalljeve të Kuvendit të Komunës.

Neni 79

Ky ndryshim – Amandament në Statutin Komunal hyn në fuqi pas procedurës së diskutimit publik dhe miratimit nga ana e Kuvendit Komunal Junik.

Neni 80

Të gjitha aktet e Komunës, brenda gjashtë muajve, duhet të harmonizohen me dispozitat e këtij statuti.

Neni 81

Interpretimi autentik i këtij statuti bëhet nga Kuvendi i Komunës Junik .

**Junik;
29.09.2010**

**KUVENDI I KOMUNËS JUNIK
KRYESUESI I KUVENDIT**

Sinan Gacaferi

P Ë R M B A J T J A

STATUTI I KOMUNËS - JUNIK.....	1
KAPITULLI I	1
Dispozitat e përgjithshme	1
Qëllimi	1
Përkufizimet.....	1
Selia.....	3
Festa e Komunës	4
Simbolet	4
Gjuhët.....	5
Kompetencat e Komunës	5
Kompetencat vetanake	5
Kompetencat e deleguara.....	6
Organet e Komunës.....	6
Organet e Komunës janë:.....	6
KAPITULLI II	7
VENDBANIMET E KOMUNËS	7
Fshatrat dhe vendbanimet	7
Jasiq dhe Gjocaj.....	7
Bashkëpunimi ndërkomunal	7
Marrëveshjet brenda Komunës	7
Shtrirja administrative në vendbanimet e Komunës	8
KAPITULLI III.....	9
PASURIA DHE FINANCAT E KOMUNËS	9
Pasuria e komunës.....	9
Financat komunale	9
KAPITULLI IV	11
FUNKSIONIMI DHE PËRGJEGJËSITË E KUVENDIT TË KOMUNËS DHE	
KOMITETEVE.....	11
Funksionimi dhe përgjegjësitë	11
Aktet e Kuvendit të Komunës	12
Anëtarët e Kuvendit	12
Informimi i anëtarëve të kuvendit për çështjet komunale.....	12
Konflikti i interesave.....	13
Mbledhja e parë dhe betimi i anëtarëve	13
Kryesuesi i Kuvendit të Komunës	13
Zevendeskryesuesi i Kuvendit të Komitetit për Komunitete	14
Rregullorja e punës	14
Thirrja e mbledhjeve dhe përcaktimi i rendit të ditës	14
Kuorumi dhe mënyra e votimit	15
Procesverbali	15
Shpërndarja e kuvendit jofunksionues të komunës.....	15
Kompensimi.....	16
Komitetet e Kuvendit të Komunës.....	16
Komitetet.....	16

Komiteti për Politikë dhe Financa	16
Komiteti për Komunitete	17
Komitetet tjera	17
KAPITULLI V	18
UDHEHEQESIA KOMUNALE/ EKZEKUTIVI	18
Zgjedhja e kryetarit të komunës.....	18
Betimi.....	18
Përgjegjësitë.....	18
Kryetari i komunës i zbaton përgjegjësitë në vijim:	19
Aktet e Kryetarit të Komunës	19
Konflikti interesit	19
Nënkryetari i Komunës	20
Nënkryetari i Komunës për komunitete	20
KAPITULLI VI	21
ADMINISTRATA KOMUNALE	21
Organizimi i brendshëm.....	21
Zyra e Kryetarit të komunës	21
Drejtorit komunale	22
Drejtoria për Administratë	22
Drejtoria për Buxhet dhe Financa	22
Drejtoria e Ekonomisë dhe Zhvillimit	22
Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Ambient	23
Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport.	23
Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.....	23
Drejtoria për Shërbime Publike Inspeksion Mbrojtje dhe Shpëtim	23
Këshilli i Drejtoreve.....	24
KAPITULLI VII	25
SHËRBIMI CIVIL KOMUNAL	25
Shërbyesi civil.....	25
Udhëheqja	25
Udhëheqësi i personelit.....	25
Punësimi.....	25
Administrimi financiar.....	26
Buxheti i Komunës	26
Të hyrat nga Ministria e Financave dhe e Ekonomisë.....	26
Të hyrat vetanake të Komunës.....	27
Të hyrat tjera	27
Të hyrat nga donatorët	27
Të hyrat nga vetëkontributi	27
Huamarrja komunale.....	28
KAPITULLI VIII.....	29
Raporti vjetor	29
Ndërmarrjet publike lokale	29
KAPITULLI IX	29
Auditori i brendshëm	29
KAPITULLI X.....	30

TRANSPARENCA, KONSULTIMET ME PUBLIKUN, DHE MEKANIZMAT E	
PJESËMARRJES SË QYTETARËVE.....	30
Transparenca	30
Takimet publike, konsultimet dhe pjesëmarrja e publikut.....	30
Iniciativa e qytetarëve	31
KAPITULLI XI	32
DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE	32